



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:110859
Datë: 17.01.2024
Numri i dokumentit: 05200163

PA1.nr.1321/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Pergjithshem, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Mehmet Ndrecaj, anëtarë, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të akuzuarit I.Sh., nga fshati..., K. Drenas, për shkak të veprës penale Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, të ushtruara kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr. 2169/2016 të datës 13.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 20 Dhjetor 2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit I.Sh., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr. 2169/2016 të datës 13.07.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr. 2169/2016 të datës 13.07.2023, i akuzuari I.Sh., është shpallur fajtor për shkak të veprës Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të cilën është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve me kusht se i njëjti dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen tjetër veprë penale si dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro e të cilën gjobe është i obliguar që ta paguajë në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në të kundërtën dënimi me gjobe do të i zëvendësohet në dënim me burgim kur për çdo 20 euro të gjobës do të i llogaritet 1 ditë burgim.

I akuzuari është obliguar që të paguaje shpenzimet e procedurës penale të cilat dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumen prej 20 (njëzet) euro si dhe në emër të super-ekspertizës financiare shumen prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara Dogana e Kosovës për realizimin e kërkesave tjera eventuale pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet, dhe të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor të i shqiptohet dënim më i lartë se sa dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e me të cilin dënim do të arrihej qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit I.Sh. – av.Selman Bogiqi nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe i akuzuari në mungesë të provave të lirohet nga akuza apo aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u shkjaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit I.Sh., me shkresën e vet PPA.II.nr. 1355/23 të datës 23.10.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren ta aprovojë si të bazuar ndërsa ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 390 paragrafi 1 të KPPRK-së, në të cilën prezantuan mbrojtësi i të akuzuarit I.Sh., si dhe përfaqësuesja e të dëmtuarës Dogana e Kosovës – zyrtarja K.Sh., ndërsa palët e tjera munguan edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt, andaj seanca e kolegjit u mbajt në pajtim me nenin 390 paragrafi 4 të KPPRK-së. Mbrojtësi i të akuzuarit në tërësi mbeti pranë ankesës së ushtruar me shkrim dhe pas elaborimit të së njëjtës propozoi që ankesa të aprovohet si e bazuar. Përfaqësuesja e të dëmtuarës – Dogana e Kosovës, propozoi që ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet dhe deklaroi se parashtron kërkesë pasurore juridike.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ato të mbrojtësit së të akuzuarit I.Sh., dhe gjeti se :

- **Ankesat nuk janë të bazuara.**

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale mbrojtësi i të akuzuarit I.Sh., me ankese pretendon se aktgjykimi shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën par.1.12 e lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPPRK-së, me arsyetim se dispozitivi i aktgjykimit të kontestuar është i pakuptueshëm, është kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyet e

paraqitura ne arsyetimin e aktgjykimit. Sipas mbrojtësit në aktgjykim nuk janë paraqitur arsytet lidhur me faktet vendimtare ndërsa arsytet e paraqitura janë plotësisht te paqarta dhe ne masë të konsiderueshme kundërtënëse. Sipas mbrojtësit së te akuzuarit Gjykata e shkalles se pare ne aktgjykimin e ankimuar nuk i ka paraqitur ne mënyre te plote faktet e vërtetuara dhe te pa vërtetuara, e të cilat shkelje aktgjykimin e shkalles se pare e bëjnë te paqëndrueshëm për çka të njëjtin duhet anuluar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore te mbrojtësit të të akuzuarit I.Sh., lidhur me shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale dhe konstatoi se te njëjtat nuk janë te bazuara ngase aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare është i qarte dhe i kuptueshëm dhe si i tille përmban arsye te mjaftueshme përkitazi me faktet relevante te kësaj çështje juridiko penale si dhe faktet nga te cilat varet edhe aplikimi i drejte i dispozitave te ligjit penal. Theksimet e lartpërmendura ne ankese nuk janë te natyrës se tille për te konstatuar se aktgjykimi përmban mangësi te atilla procedurale qe do ta bënin te paqëndrueshëm ligjshmërinë e tij. Gjykata e shkalles se pare ne mënyre te drejte dhe te plote i ka vërtetuar te gjitha faktet vendimtare te kësaj çështje dhe se eshte mbështetur ne provat e administruara si deklarata e te akuzuarit I.Sh., e dhënë pranë sektorit të hetuesisë ne doganën e Kosoves me 25.08.2015 dhe ne Prokurorinë Themelore ne Prizren me datë 06.06.2016, deklaratën e përfaqësuesit se Doganes se Kosoves të dhënë ne gjykatë me 21.05.2021, deklaratën e dëshmitarit – doganierit M.S., e dhënë ne gjykatë me datë 15.06.2021, ekspertizën financiare të ekspertit B.I. e dhënë me datë 07.12.2015, ekspertiza financiare e ekspertit financiar R.F., e dhënë me datë 28.09.2021, shënimi zyrtar i ekspertit financiar R.F., lidhur me urdhëresën per plotësim te ekspertizës se datës 23.12.2021, ekspertiza financiare e ekspertit financiar R.B., e datës 10.10.2022 dhe super-ekspertiza financiare e grupit te eksperteve A.K., B.B. dhe I.K., e datës 05.12.2022. Andaj pretendimet ankimore lidhur me mos vërtetimin e fakteve vendimtare lidhur me kete çështje, Gjykata e Apelit i refuzoi si te pabazuara.

Sa i përket vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, mbrojtësi i të akuzuarit I.Sh., pretendon se si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes se ligjit penal ne dem te të akuzuarit ka ardhur deri te vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ngase nuk është vërtetuar fakti se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor, siç është pretenduar në aktakuzë e që këto fakte nuk janë vërtetuar as pas administrimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve andaj gjykata sipas mbrojtësit të akuzuarin e ka shpallur fajtor pa u plotësuar elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore te mbrojtësit të të akuzuarit lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe konstatoi se te njëjtat nuk janë te bazuara ngase janë ne kundërshtim me provat e administruara si : deklaratën e përfaqësuesit se Doganës se Kosovës të dhënë ne gjykatë me 21.05.2021, deklaratën e dëshmitarit – doganierit M.S., e dhënë ne gjykatë me datë 15.06.2021, ekspertizën financiare të ekspertit B.I., e dhënë me datë 07.12.2015, ekspertiza financiare e ekspertit financiar R.F., e dhënë me datë 28.09.2021, shënimi zyrtar i ekspertit financiar R.F., lidhur me urdhëresën per plotësim te ekspertizës se datës 23.12.2021, ekspertiza financiare e ekspertit financiar R.B. e datës 10.10.2022 dhe super-ekspertiza financiare e grupit te eksperteve A.K., B.B. dhe I.K., e datës 05.12.2022, e ne baze te te cilave konstatohet se gjykata e shkalles se pare, drejte dhe ne mënyre te plote ka vërtetuar gjendjen faktike ne rastin konkret, andaj edhe pretendimet ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike i refuzoi si te pabazuara si dhe konstatoi se ne rastin konkret kur i akuzuari

është shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, drejte është aplikuar edhe ligji penal, për çka edhe pretendimet e mbrojtësit lidhur me shkeljen e ligjit penal në dëm të akuzuarit i refuzoi si të pabazuara ngase ne veprimet e te akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive te veprës penale Shmangia nga pagesa e tarifave te detyrueshme doganore nga neni 318 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor. Gjithashtu edhe pretendimet ankimore lidhur me parashkrimin absolut te ndjekjes penale i refuzoi si te pabazuara ngase ne rastin konkret ende nuk ka arritur parashkrimi ngase vepra penale është kryer deri me datë 30.07.2014.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal Prokuroria Themelore ne Prizren, me ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar ndaj te akuzuarit nga ana e gjykatës se shkalles se pare është i ulët dhe me këtë dënim nuk mund te arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së dhe ka propozuar që aktgjykimi i shkalles se pare te ndryshohet dhe te akuzuarit per veprën penale për të cilën është shpallur fajtor t'i shqiptohet një dënim më i lartë e cili do te ishte ne përpjesëtim me peshën e veprës penale te kryer, rrezikshmërinë shoqërore te veprës penale dhe përgjegjësinë penale te kryesit.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, mbrojtësi i të akuzuarit I.Sh., me ankesë nuk e atakon aktgjykimin lidhur me këtë baze ankimore ngase pretendon se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale dhe se i njëjti duhet te lirohet ne mungesë të provave, megjithatë Gjykata e Apelit e vlerësoi edhe ne këtë aspekt dhe konstatoi se gjykata e shkalles se pare me rastin e vendosjes ne lidhje me sanksionin penal ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese te parapara me nenin 69 dhe 70 te KPRK-se e te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, me bindje se me dënimin e shqiptuar nga ana e Gjykatës se shkalles se pare, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerëses nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i saj, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit. Andaj edhe ankesën e Prokurorisë Themelore ne Prizren per shqiptimin e dënimit më të lartë e refuzoi si te pabazuar.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1321/23 më 20.12.2023

Procesmbajtës
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit
Skender Çoçaj

Mehmet Ndrecaj